



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 329/11 Prot.

Koplik, me: 12 / 02 / 2026

V E N D I M

NR 8 DATË 11 / 02 / 2026

PËR  
RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË MALËSIA E  
MADHE

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe në mbledhjen e tij me datë 11.02.2026, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 54, në mbështetje të nenit 8, pika 1, neni 22 pika 1, neni 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrative-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", neni 13, pika 1.b, neni 27 pika 2, neni 12 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar,

VENDOSI

1. Miratimin për rishikimin e Planit të Pergjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miraturar me 11.02.2026

Vota Pro 21

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.02.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN PROJEKTEVE DHE KADASTRES  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT URBAN

Nr. 329 Prot.

Koplik, më: 03/07 /2026

PROJEKT - VENDIM

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_ / \_\_\_ /2026

**PËR**  
**RISHIKIM E PLANIT TE PËRGJITHSHËM VENDOR TE BASHKISË**  
**MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM-në Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, nenet 11 dhe 12.

**.PROPOZOJ:**

- 1- Miratimin e rishkimit të planit të përgjithshëm të Bashkisë Malësi e Madhe.
- 2- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban Projekteve, Kadastres dhe Bujqësisë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër

**KRYETAR**  
**TONIN MARINAJ**





## BASHKIA MALËSI E MADHE

RISHIKIMI I PLANIT TË PËRGJITHSHEM VENDOR

Raport përmbledhës I kërkesave për ndryshime

Draft nr

Datë 10/05/2024



**Hartoi:**

1. Ermelinda Volaj
2. Xhenisa Dushaj
3. Lombardo miculi
4. Erald Kurtulaj
5. Ermal Ademaj

*(Planifikues, ekspert GIS)*

*(Planifikues)*

*(Arkitekt)*

*(Ing. Mjedis)*

*(Jurist)*

Tabela e përmbajtjes

KREU I

*NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË*

KREU II

*NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT*

KREU III

*NDRYSHIME NË HARTËN E RRJETIT RRUGOR DHE INFRASTRUKTUROR*

SHTOJCA I

*TABELA PËRMBLEDHËSE E NJËSIVE STRUKTURORE KU KËRKOHEN NDRYSHIME DHE NJËSIVE TË REJA QËPROPOZOHEN TË SHTOHEN*

SHTOJCA II

*RAPORTI I EKSPERTIT TË MJEDISIT MBI SECILIN PREJ RASTEVE TË PROPOZUARA PËR RISHIKIM.*



2

## KREU I

### *NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË*

- Në nenin 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 3 ndryshon si më poshtë:

*Kufizimi i ndërhyrjeve në afërsi të monumenteve të natyrës: Në zonat e evidentuara si monumente natyrore dhe të shpallura të tilla me Vendim të Këshillit të Ministrave, ndërhyrjet që mund të kryhen duhet të jenë sipas kushteve të kategorive dhe nënkategorive të parashikuara në legjislacionin sektorial dhe në përputhje me kushtet e infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse në planet e menaxhimit të tyre. Bashkia mund të parashikojë kufizime më të mëdha me Planin e Peizazhit.*

Ky ndryshim kërkohet për arsye të harmonizimit me ndryshimet në ligjin për zonat e mbrojtura dhe që reflektohet edhe në kushtete e kërkesave për leje ndertimi nga subjektet private në territor.

Ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 (i ndryshuar), VKM nr. 408/2015 (e ndryshuar), ligjit 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” (i ndryshuar).

Lloji I ndryshimeve për këtë rast plotëson kushtet sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të VKM nr. 686/2017 për rishikim të Plnit të Përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar.

- Në nenin 40 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:
  - i. Në kreun “A. Parashikime të përgjithëshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “5-Përqindja e sipërfaqes së ndërtimit sipas përdorimit” ndryshohet në: “80% banim dhe 20% shërbime, përjashtim bën Njësia KO\_02-A12-15 ku përqindja e sipërfaqes së ndërtimit sipas përdorimit do jetë 55% banim dhe 45% shërbime”

Kjo për shkak të legalizimit të ndërtimeve informale në Njësi dhe nevojës për rikonstrukcion për shkak të amortizimit të ndërtimit deri në fazën përkatëse.

Ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 (i ndryshuar), VKM nr. 408/2015 (e ndryshuar).

Lloji I ndryshimeve për këtë rast plotëson kushtet sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të VKM nr. 686/2017 për rishikim të Plnit të Përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar.

## KREU II

### *NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT*

- Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KA\_05-IN33-01:

Është i nevojshëm korigjimi i kategorisë së përdorimit pasi edhe në momentin e hartimit dhe miratimit të PPV, prona është përdorur për shërbime (bar-restorant).

Kushtet aktuale:


Njësia Strukturore: KA\_05-IN33-01

Bashkia	Malësi e Madhe
Njësia	KA_05-IN33-01
Sistemi	IN_Infrastrukturor
Kategori 1	IN3-INFRASTRUKTURE ENERJITIKE
Kategori 2	
Kategori 3	
Kategori 4	
Lartësia në Kate	NENI 78
Lartësia në Metra	
PDV	N/A
Intesitet	K1=NENI 78
KSHT	K1=NENI 78
KSHR	K1=Neni 78
KSHP	K1=Neni 78
Kufizime Ligjore	
Sipërfaqe (ha)	0.44



**Propozohen kushtet si më poshtë:**

<i>Sistemi</i>	<i>UB_Urban</i>
<i>Kategori 1</i>	<i>S-ZONA SHERBIMESH</i>
<i>Lartësia në Kate</i>	<i>NENI 55 PIKA B5</i>
<i>PDV</i>	<i>JO</i>
<i>Intesitet</i>	<i>K1=1</i>
<i>KSHT</i>	<i>K1=40%</i>
<i>KSHR</i>	<i>K1=GJ.E</i>
<i>KSHP</i>	<i>K1=GJ E</i>
<i>Sipërfaqe (ha)</i>	<i>0.44</i>
<i>Parcela_Minimale</i>	<i>Jo më pak se 600 m2</i>
<i>Përdorime të Lejuara</i>	<i>S – Zona Shërbimesh</i>
<i>Përdorime të Ndaluara</i>	<i>Neni 7</i>



Ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 (I ndryshuar), VKM nr. 408/2015 (e ndryshuar).


Lloji I ndryshimeve për këtë rast plotëson kushtet sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të VKM nr. 686/2017 për rishikim të Plnit të Përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar.

- Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” njësia strukturore **KO 04-B11-02** ndahet në nënnjësine **KO 04-B2-02** dhe Nënnjësia e re propozohet të ketë kushtet e mëposhtme:

Bashkia	Malësi e Madhe
Njësia	KO_04-B2-02
Sistemi	B_ Bujqësor
Kategori 1	B2-AKTIVITETE EKONOMIKE DHE BUJQESORE
Lartësia në Kate	2 KATE
PDV	JO
Intesitet	K1=NENI 88 PIKA B1
KSHT	K1=60%
KSHR	K1=GJ.E
KSHP	K1=N/A
Sipërfaqe (ha)	2.6
Parcela_Minimale	Në zonë synohen zhvillime me sipërfaqe jo më të vogla se 1 ha
Përdorime të Lejuara	B2 – Prodhimtari, Përpunim, Tregtim
Përdorime të Ndaluar	Neni 7



## Plani i Përgjithshëm Vendor



4/22/2024, 1:13:29 PM


Njësia Strukturore

- A. Banim
- AS Ars'm
- B. Tokë Bujqësore
- IE, Industri Ekonomik

- IMB,Infrastruktura Menaxhimi Mbetjesh
- INT,Infrastruktura Transporti
- SHA, Aktivitete Shqiptare & Argetimi
- V.Varreza

PPV Rrjeti Rrugor i Propozuar

- A. Autostrade
- E. Rruge Urbane Dytësore
- F. Rruge Lokale



AKPT

Kushtet aktuale Te Njesise:

**Njësia Strukturore: KO\_04-B11-02**


Bashkia	Malësi e Madhe
Njësia	KO_04-B11-02
Sistemi	B_ Bujqësor
Kategori 1	B1-ZONA BUJQESORE
Kategori 2	
Kategori 3	
Kategori 4	



Lartësia në Kate	N/A
Lartësia në Metra	
PDV	N/A
Intesitet	K1=N/A
KSHT	K1=N/A
KSHR	K1=N/A
KSHP	K1=N/A
Kufizime Ligjore	Respektimi i përcaktimeve ligjore të VKM Nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
Sipërfaqe (ha)	102.82
Nenkategori 1	
Nenkategori 2	
Nenkategori 3	
Nenkategori 4	
Parcela_Minimale	Sipas gjendjes ekzistuese
Përdorime Lejuara	të B11 – Toka Arë
Përdorime Ndaluara	të Neni 7

Duke qënë se nënjesia që kërkohet të krijohet ndodhet në kufi me zona të parashikuara për zhvillim industrial dhe ekonomik, gjykohet që është e favorshme për nxitjen e zhvillimit ekonomik të zones mbështetja e iniciativave të sektorit privat për rritjen e kapaciteteve të logjistikes në mbështetje të bashkëpunimit me tregun e huaj për produktet bujqesore të zones. Në këtë mënyrë nxit edhe fermerët që të kenë shumëllojshmëri në prodhimin e kulturave të ndryshme bujqësore.

Ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 (I ndryshuar), VKM nr. 408/2015 (e ndryshuar), ligjit 9244/2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore"



Lloji I ndryshimeve për këtë rast plotëson kushtet sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të VKM nr. 686/2017 për rishikim të Plnit të Përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar.

- Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore **KO\_04-B2-02**:
  - a) Njësia administrative, “Koplik”;
  - b) Zonimi në territor, “KO\_04”;
  - c) Sistemi, “B-Bujqësor”;
  - d) Kategoria, “B2-Aktivitete Ekonomike Bujqësore”;
  - e) Përdorimi, “B2-Prodhitari, Përpunim, Tregtim”;
  - f) Njësia, “KO\_04-B2-02”;
  - g) Zona e mbrojtur, “-”;
  - h) KSHT, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”;
  - i) KSHR, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”;
  - j) KSHP, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”;
  - k) Intensiteti, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”;
  - l) Intensiteti me kusht, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”;
  - m) Dendësia/Banorë, “xxx”;
  - n) Lartësia, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”
  - o) Lloji i ndërhyrjes, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”
  - p) Shërbime, “Çdo zhvillim në këtë njësi duhet të zbatohet bufer nga rruga nacionale dhe nuk duhet të ketë dalje në rrugë nacionale”
  - q) PDV, “JO”;
  - r) Prioriteti, “VKM nr. 283, datë 1.4.2015, të ndryshuar”
  - s) Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara, “Neni 7”;
  - t) Funkcionet aktuale, “Neni 6”;
  - u) Sipërfaqja e njësisë, “2.6ha”;
  - v) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën X.

Kushtet aktuale zhvillimore:

Njësia Strukturore: GR\_01-B11-01

Bashkia Malësi e Madhe

Njësia GR\_01-B11-01



<i>Bashkia</i>	<i>Malësi e Madhe</i>
<i>Njësia</i>	<i>GR_01-B12-11</i>
<i>Sistemi</i>	<i>B_ Bujqësor</i>
<i>Kategori 1</i>	<i>B1-ZONA BUJQESORE</i>
<i>Lartësia në Kate</i>	<i>2 KATE</i>
<i>PDV</i>	<i>N/A</i>
<i>Intesitet</i>	<i>K1=0.1</i>
<i>KSHT</i>	<i>K1=10%</i>
<i>KSHR</i>	<i>K1=N/A</i>
<i>KSHP</i>	<i>K1=N/A</i>
<i>Sipërfaqe (ha)</i>	<i>6.62</i>
<i>Parcela_Minimale</i>	<i>Jo më pak se 1000 m<sup>2</sup></i>
<i>Përdorime të Lejuara</i>	<i>B12 – Toka Bahçe</i>
<i>Përdorime të Ndaluar</i>	<i>Neni 7</i>

Sipas kërkesave për krijimin e zonave të akomodimit sezonal në struktura të lehta tipologjike të brigjeve të liqeneve si paraprirje e investimeve të parashikuara bashkarisht me Bashkinë Shkodër për rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së aksesit të vijës së Liqenit të Shkodrës.

Ndryshimi i kërkuar është në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit 107/2014 (I ndryshuar), VKM nr. 408/2015 (e ndryshuar), ligjit 9244/2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”

Lloji I ndryshimeve për këtë rast plotëson kushtet sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 11 të VKM nr. 686/2017 për rishikim të Plnit të Përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar.



10

## KREU III

### SHTOJCA II

#### RAPORTI I EKSPERTIT TË MJEDISIT

#### RAPORT I NDIKIMIT NË MJEDIS I RISHIKIMIT TË PPV MALËSI E MADHE

Në vijim të përcaktimeve të ligjit nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" për fushën e zbatimit të tij për Planet e Përgjithshme Vendore dhe rishikimet që kanë si objekte dhënjen e lejeve të ndërtimit për objektet sipas shtojcave I dhe II të ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", do bëhet përshkrimi nëse rastet subjekt i këtij rishikimi kanë nevojë për hartim të vlerësimit strategjik mjedisor.

Njësitë Strukturore subjekt i rishikimit janë si vijon:

- KA\_05-IN33-01 Parashikohet korigjim i kategorise se perdorimit
- KO\_04-B11-02 Ndryshim I kufijve te Njesise
- KO\_04-B2-02 Krijim Njesie e re me perdorim bujqesor (aktivitet ekonomik)
- SH\_10-N11-05
- SH\_10-N11-06
- SH\_10-N22-03
- SH\_10-N11-05/1
- SH\_10-N11-06/1

Rastet e sipërcituara janë rishikime të kushteve zhvëllimore brenda të njëjtit sistem që është parashikuar në PPV e miratuar, pra ndikimi në mjedis është sipas kushteve të vlerësimit strategjik mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe.

Duke u mbështetur në ligjin Nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor (VSM)", sikurse dhe të VKM-së Nr.219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor" theksojmë:

- Aktivitetet e parashikuara në PPV-në e rishikuar janë parashikuar të zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit, duke mbajtur gjithashtu në konsideratë referencat e përditësuara të kuadrin ligjor, konkretisht ndër të tjera :Ligji Nr. 41/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit" , të ndryshuar,Ligji



Nr.46/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.10 006, datë 23.10.2008,"Për mbrojtjen e faunes së egër", të ndryshuar, Ligji Nr.57/2020 "Për Pyjet" , Strategjia Kombëtare e Mbetjeve miratuar me VKM nr.418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve,2020-2035";

- Përputhshmërinë dhe respektimin e Konventave, marrëveshjeve dhe Protokolleve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në të cilat Shqipëria është palë;
- Ndryshimet në PPV, sikurse dhe zbatimin e Planit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe janë parashikuar të jenë në përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor në lidhje me menaxhimin e mbetjeve;
- Cdo projekt në zbatim të kësaj PPV-je, privat apo publik , të listuar në shtojcat I dhe II të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar , janë parashikuar ti nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Zbatimin e masave të detajuara për mbrojtjen e mjedisit, pjesë e dokumentit, të Deklaratës Mjedisore për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe.

Rrjedhimisht, rishikimi në këtë rast nuk ka nevojë të hartimit të vlerësimit strategjik mjedisor pasi kushtet e ndikimit në mjedis të ndërtimeve të reja në njësitë strukturore të sipërcituara nuk ndryshojnë me ato të parashikuara dhe miratuara me miratimin e PPV Malësi e Madhe në vitin 2017.

Punoi: **Erald Kurtulaj**

Inxhinier Mjedisori



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KRYETARI

VENDIM  
Nr. 50, datë 01/5/2024

**“PËR NDËRMARRJEN E NISMËS SË RISHIKIMIT TË DOKUMENTIT TË PLANIT  
TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR, BASHKIA  
MALËSI E MADHE”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vnedore”, i ndryshuar, në nenin 13 pika Ishkronja (b), në nenin 26 të ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM 686/2017 “Per miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

Vendosi:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të Përsheptuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
  - Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjadisis, zonave të mbrojtura, trashëgimisë historike dhe kulturore, duke mos cënuar vlerat e tyre;
  - Janë në përputhje, nuk ndikojnë apo ndryshojnë vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njërive vendore si dhe drejtimet kryesore të zhvillimit, të parashikuara në dokumentin e PPV-së së miratuar;
  - Janë në përputhje, nuk bien në kondërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;
  - Nuk përfshijnë ndryshime të kategorive të përdorimit të tokës nga një sistem territorial në tjetrin.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.



... e kësaj vendimi nga Këshilli i Drejtorit të Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe Dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.



**KRYETAR**  
*[Signature]*  
**TONIN MARINAJ**



*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE

# NISMA

PËR RISHIKIMIN E  
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA MALËSI E MADHE

KRYETARI

TONIN MARINAJ



...2024

# TABELA E PËRMBAJTJES

HYRIE	3
BAZA LIGJORE	4
1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT	5
2. DOKUMENTET, PIESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT.....	6
3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË.....	7
4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE.....	7
5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT.....	8
6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË MALËSI E MADHE.....	9



## HYRJE

Bashkia Malësi e Madhe ndodhet në Shqipërinë Veri-Perëndimore. Ajo përbëhet nga 6 Njësi Administrative, respektivisht: Njësia Gruemirë, Njësia Qendër, Njësia Koplík, Njësia Kastrat, Njësia Shkrel dhe Njësia Kelmend. Bashkia ka një sipërfaqe prej 1,051.989 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 56,054 banorë.

Në Malësinë e Madhe dallohet relief i thyer kryesisht në pjesën lindore të saj me lartësi maksimale të qendrave të banuara që arrijnë në 1,665m mbi nivelin e detit në Qafë Thore në Bogë dhe në 1,450m mbi nivelin e detit në Qafë të Perdeleci në Lëpushë. Vendbanimet më të ulta shtrihen në pjesën perëndimore të territorit të Bashkisë përgjatë vijës bregliqenore të Liqenit të Shkodrës.

Vija bregliqenore që përfshihet në territorin e Malësisë së Madhe arrin përafërsisht në 32 km lineare dhe është pjesë e Zonave të Mbrojtura sipas ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura".

Karakteristikat e relievit janë pasqyruar vazhdimisht në tipologjinë ndërtimore të zgjedhur nga banorët e zonës dhe kanë mbetur të pandryshuara deri në vitet e fundit ku ka filluar të implementohen dhe karakteristika të reja qoftë në materialet ndërtimore të përdorura qoftë në arkitekturë duke e bërë më funksional objektin ndërtimor por duke iu përshtatur në vazhdimësi natyrës.

Bashkia e Malësisë së Madhe kufizohet me Bashkinë Shkodër në Jug dhe Perëndim dhe ka kufi shtetëror me Malin e Zi në pjesën tjetër të tij.

Me këtë të fundit janë tre pika doganore që mundësojnë lëvizjen si për mallra, ashtu dhe për personat, pika e Hanit të Hotit, pika kufitare në Grabom dhe ajo në Vermosh.

Me hapjen e rrugës "Shkodër-Hani i Hotit" dhe "Hani i Hotit-Vermosh", është rritur ndjeshëm qarkullimi dhe turizmi si i brendshëm, ashtu dhe ndërkombëtar.

Meqë terreni i Bashkisë ofron turizëm malor dhe bregliqenor dhe me hapjen e infrastrukturave të reja të viteve të fundit apo të atyre që janë në proces, interesi është rritur edhe për investime të reja qoftë nga banorët e zonës me bujtina apo hapjen e shërbimeve të reja të agrobiznesit si dhe është parë si mundësi e mirë investimi për zgjerim biznesi apo krijim partneriteti dhe me biznese të huaja. Kryesisht këto të fundit janë përqendruar në magazina bujqësore apo ambiente për mbarështrimin e bagëtive, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga legjislacionin në fuqi dhe PPV e Malësisë së Madhe për lejimin e aktiviteteve ndërtimore në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Së fundmi, është rritur interesi për zhvillime në afërsi të vijës bregliqenore dhe kërkesat pranë Zyrës së Urbanistikës në Bashki për leje ndërtimi në këtë zonë janë të shumta.

Duke qënë se territori i Malësisë së Madhe shtrihet kryesisht në dy breza gjeografikë përsa i përket topografisë së tij, edhe ndërtimet e bëra në këtë territor u janë përshtatur karakteristikave të këtyre brezave sipas perspektivës historike që njerëzit kanë parë për shfrytëzimin e tyre:



- Në brezin fushor janë populluar dhe urbanizuar përgjithësisht qytetet Koplík dhe Bajzë. Është shtuar ndjeshëm interesi për zonën e bregut të liqenit për zgjerim të brezit të vendbanimeve të shpërndara duke ruajtur distancat nga vija lagëse e liqnit të Shkodrës.

Në këtë mënyrë, destinacioni për përdorim veçak dhe në disa raste me familje të mëdha apo banesa kolektive, e ka ngurtësuar vazhdimisht perspektivën e mënyrës së shfrytëzimit të ndërtimeve pavarësisht se turizmi në zonë nuk ka munguar asnjëherë.

## BAZA LIGJORE

Bashkia Malësi e Madhe kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të përshpejtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

- a. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

*"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave".*

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
- c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban:

- a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

- i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;
- ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;
- iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;
- iv. përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;
- v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;
- vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.



b) këshillimin e projektdokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", si dhe legjisllacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

## 1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Me Vendimin Nr. 3 datë 09.12.2017 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

- a. Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Malësinë e Madhe është bërë kryesisht duke parë mënyrën e shfrytëzimit të tokës nga banorët në momentin e hartimit dhe studimit të Planit dhe jo mundësinë reale për shfrytëzim.
- b. Ndryshimet në infrastrukturë rrugore dhe mbështetëse si dhe projekt-idetë për shtim të impaktit në turizëm në këtë brez, kanë shtuar interesin për investime me ipakt të ulët ndërtimor.

Për rastet në fjalë kërkohet të bëhet Rishikim i kushteve të njëjësive strukturore përkatëse që kushtet zhvillimore t'i përshtaten gjendjes ekzistuese në terren (e pandryshuar nga momenti i hartimit të PPV deri sot).

Problem tjetër i hasur gjatë punës së Zyrës së Urbanistikës në Bashkinë Malësi e Madhe për shqyrtimin e dosjeve për Leje Ndërtimi ka qënë dhe mos parashikimi i zgjerimit të zonave urbane përreth qyteteve apo zonave më të denduara të banimit në pika kyce turistike.



Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me nevojën e bashkisë për:

- c. Ndërlidhje më të mirë të kushteve të zhvillimit me gjendjen faktike
- d. Krijimin e hapësirave të reja jo vetëm për përmirësim të ndërtimeve ekzistuese por edhe të ngritjes së strukturave të reja me kapacitet më të lartë në mënyrë që të tërhiqen investitorë më të mëdhenj;

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, PPV e rishikuar do të zgjidhë problematika që lidhen edhe me nevojat në rritje të qytetarëve për shfrytëzim më të larmishëm të pronave të veta, mundësi të reja të ngritjes së infrastrukturave që mungojnë apo përmirësimin e atyre që ekzistojnë për krijimin e një rrjeti të përbashkët funksional të blloqeve të Njësive sipas përdorimeve të lejuara dhe do jetë më kompakt dhe i hapur për zhvillim të kontrolluar.

Stafi i Drejtorisë së Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës pranë Bashkisë Malësi e Madhe, ka analizuar me vëmendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkisë për çështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim rritjen e mundësive për zhvillim të kontrolluar dhe më funksional të Njësive Strukturore, nxitjen e investimeve të harmonizuara me Planin.

## 2. DOKUMENTET, PJESË E PPV, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidentuar që dokumentet që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV janë:

- a. Rregullorja e Planit
- b. Pasaportat e Njësive Strukturore
- c. Materiali hartografik

Përmbajtja e dokumentit të rishikuar të PPV do të bazohet në VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përmbajë:

- Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:

- a) ndërhyrjet në nenet e Rregullores vendore të Planit;
- b) ndërhyrje në pasaportat e njësive strukturore;
- c) etj, sipas analizimit të detajuar Planit të Përgjithshëm Vendor.

- Shtojcat përkatëse;

- Datamodel GIS me atributet përkatëse.



### 3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokument i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i Bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, përbëhet nga ekspertë të fushave:

- Të planifikimit të territorit;
- Të informacionit gjeohapësinor;
- Të mjedisit;
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës listohet si më poshtë:

1. Ermelinda Volaj (Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Projektve dhe Kadastrës, Planifikues)
2. Xhenisa Dushaj (Arkitekt)
3. Lombardo Miculi (Arkitekt)
4. Erald Kurtulaj (Ing. Mjedisit)
5. Ermal Ademaj (Jurist)

Grupi i punës do të marrë në konsideratë kërkesat e ardhura në adresë të Bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-se, do të shqyrtojë dhe do të propozojë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisë relacionet përkatëse.


### 4. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:



- 
- a. Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
  - b. Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.
  - c. Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.
  - d. Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.
  - e. Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë Malësi e Madhe.


Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

## 5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia Malësi e Madhe do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- b. Bashkia Malësi e Madhe këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- c. Vendimi i kryetarit të bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- d. Vendimi i kryetarit për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- e. Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.



**6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË MALËSI E MADHE**

Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të Bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.

Konkretisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia nuk propozon të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT  
RREGULLATOR

Nr. 966/5 prot.

Tiranë, më 18.12.2025

Lënda: Kthim përgjigje mbi propozimin për ndryshim të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Z. Tonin MARINAJ

Kryetar

BASHKIA MALËSI E MADHE

Koplik, Qendër, Malësi e Madhe

Znj. Adelina GRECA

Drejtor i Përgjithshëm

AGJENCIA KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. 357/3 datë 03.11.2025, protokolluar me tonën nr. 966, datë 07.11.2025, nëpërmjet të cilës, njoftohet Ministria e Mjedisit lidhur me propozimin për ndryshim të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Malësi e Madhe, ku kërkohet gjithashtu dhe qëndrimi i saj mbi nevojën ose jo që ndryshimi i propozuar i PPV-së t'i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, sqarojmë si vijon:

Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor (VSM)", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor", me qëllim shprehjen e qëndrimit mbi nevojën ose jo të realizimit të procesit të VSM-së, pas shqyrtimit të kërkesës, Ministria e Mjedisit mbështetet edhe tek mendimi i grupeve të interesit.

Për këtë qëllim, Ministria e Mjedisit me shkresat nr. 966/2 prot., dhe nr. 966/3 prot., datë 27.11.2025, njoftoi takimin për grupet e interesit dhe marrjen e mendimeve lidhur me prezantimin e nismës për ndryshimin e PPV-së, me synim shprehjen e qëndrimit të tyre mbi nevojën që ndryshimi i planit t'i nënshtrohet apo jo procesit të VSM-së.

Në datë 05.12.2025, ora 12:00, në ambientet e ministrisë, në bashkëpunim me autoritetin propozues u zhvillua dëgjesa publike, ku u kërkua dhënia e mendimit të tyre, për nevojën ose jo të VSM-së për rishikimin, ndryshimin apo modifikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Malësi e Madhe, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për vlerësimin strategjik mjedisor.

Ministria e Mjedisit, veç ndjekjes së procesit të informimit dhe konsultimit me grupet e interesit, mbështetet gjithashtu edhe në kriteret ndihmëse të shtojcës I të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procedurave të ndjekura sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi për vlerësimin strategjik mjedisor, Ministria e Mjedisit thekson:

1. Domosdoshmërinë që çdo zhvillim që propozohet në njësitë strukturore të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e mjedisit, duke mbajtur në konsideratë ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor në fushën e mjedisit, kryesisht: Ligji nr.9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar, Ligji nr. 10 006, datë 23.10.2008. "Për mbrojtjen e faunës së egër". të ndryshuar, Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", i ndryshur. Strategjia Kombëtare e Mbetjeve miratuar me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035"; Ligji nr. 57 datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; Shtojca, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme", të ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", Ligji nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike", i ndryshuar si dhe Ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar.
2. Përputhshmërinë e nevojshme dhe respektimin e Konventave, marrëveshjeve dhe Protokolleve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në të cilat Shqipëria është palë;
3. Detyrimin që ndryshimet në PPV, dhe zbatimi i Planit në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe të jenë në përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, sistemimin dhe menaxhimin e rrjetit të kanalizimeve dhe ujrave të ndotura, gjithashtu edhe bonitetin e tokës.
4. Detyrimin që çdo projekt në zbatim të kësaj PPV-je, privat apo publik, i listuar në shtojcat I dhe II të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
5. Kërkesën për zbatimin e masave të detajuara për mbrojtjen e mjedisit, pjesë e dokumentit, të Deklaratës Mjedisore për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe
6. Zbatimin e ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar dhe akteve të tij nënligjore, pasi bazuar në verifikimin e njësisve strukturore të paraqitura në dokumentacion rezulton se:
  - Njësia strukturore SH\_10-N11-05 ndodhet në ZM "Park Kombëtar Alpet e Shqipërisë" ku pjesa më e madhe e sipërfaqes ndodhet në nënzonën ZPT/Q, në pjesë të vogla prek në nënzonën ZQ dhe vazhdon në kufi me nënzonën ZQ.
  - Njësia strukturore SH\_10-N11-06 ndodhet në ZM "Park Kombëtar Alpet e Shqipërisë" ku pjesa më e madhe e sipërfaqes ndodhet në nënzonën ZPT/Q, në pjesë të vogla prek në nënzonën ZQ dhe vazhdon në kufi me nënzonën ZQ. Brenda sipërfaqes së njësisë ndodhet MN "Mrizi (ahu) i pleshtit (Bogë)".
  - Njësia strukturore SH\_10-N22-03 ndodhet në ZM "Park Kombëtar Alpet e Shqipërisë" në nënzonën ZPT/Q.
  - Njësia strukturore KA\_05-IN33-01 dhe KO\_04-B11-02 nuk bën pjesë në rrjetin e ZM.

- Njësia strukturore KO\_04-B2-02, SH\_10-N11-05/1 dhe SH\_10-N11-06/1 nuk mund të shpreheni nëse janë pjesë e rrejtit të ZM pasi mungojnë pika me koordinata ose planvendosje dhe janë njësi të reja dhe nuk janë të publikuara në ArcGIS Online (e-planifikimi).
- 7. Mbajten në konsideratë të kuadri ligjor për zonat e mbrojtura dhe për pyjet, në pikën 5, të Kreut I të dokumentacionit të paraqitur, lidhur me ndërhyrjet që do të realizohen.
- 8. Mbajten në konsideratë për zbatimin e akteve ligjore dhe nënljgore në fushën e mbetjeve, me qëllim moskrijimin e grumbullimeve të inerteve në zonë, gjatë krijimit të këndeve të lojërave, në të cilat do të përdoren goma të riciklueshme (prashikuar në pikën 3, të Kreut I të dokumentacionit të paraqitur).
- 9. Përditësimin në pikën 5, të Kreut I, të termit “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” me “Ministria përgjegjëse për mjedisin”,

shpreh qëndrimin e saj se:

Propozimi i Bashkisë Malësi e Madhe, për ndryshim të PPV-së, sipas dokumentit të përcjellë, mund të vijojë procedurat, pa nevojën që t'i nënshtrohet procesit të VSM-së, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër.

Duke Ju falënderuar,

MINISTRI

SOFJAN JAUPAJ

